



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË

Nr. 9301/3 Prot.

Tiranë, më 13.09.2018



MIRATOHET

MINISTËR

LINDITA NIKOLLA

**Profili: Klasa e profilizuar sportive**

**Sistemi: Arsimi i mesëm i ulët**

**Lënda: Futboll (djem dhe vajza)**

**KLASA: VII**

Tiranë, 2018



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË  
INSTITUTI I ZHVILLIMIT TË ARSIMIT**

**PROFILI: Klasa e profilizuar sportive**

**SISTEMI: Arsimi i mesëm i ulët**

**LËNDA: Futboll (djem dhe vajza)**

**KLASA: VII**

**Tiranë, 2018**

## TABELA E PËRMBAJTJES

TABELA E PËRMBAJTJES.....	2
1 HYRJE.....	3
2 QËLLIMI I PROGRAMIT TE FUTBOLLIT .....	3
3 SYNIMET E PROGRAMIT TË FUTBOLLIT .....	3
4 KOHA MËSIMORE PËR ÇDO TEMATIKËTË PROGRAMIT .....	4
5 PËRMBAJTJA E PROGRAMIT TËFUTBOLLIT, KLASA 7-TË .....	5
6 NJOHURITË DHE REZULTATET E TË NXËNIT, SIPAS TEMATIKAVE, KLASA E SHTATË .....	6
7 UDHËZIME METODOLOGJIKE PËR ZBATIMIN E PROGRAMIT .....	12
8 UDHËZIME PËR VLERËSIMIN E NXËNËSVE .....	13
9 MATERIALE BURIMORE.....	17

## 1 HYRJE

Programi i futbollit, si rezultat i zhvillimit dhe hapit cilësor që ka sporti i futbollit në vendin tonë, si dhe për ta çuar në nivele konkurruese me futbollin bashkëkohor, kërkon një përcaktim të saktë të strukturës dhe përmbajtjes, duke luajtur një rol vendimtar në procesin e formimit dhe përsosjes së aftësive funksionale të nxënësve, të ngritjes së mjeshtërisë sportive. Këtu del detyra që të saktësohet programi dhe të bëhet lidhja e seancave mësimdhënëse (mësimore), me një proces pedagogjik unik. Programi i kësaj lënde do të përfshijë të gjitha elementet teknike të lojës së futbollit, rregulloren e lojës, duke synuar grumbullimin dhe përvetësimin e njohurive që ndihmojnë nxënësin sportist të krijojë imazhin e saktë të ekzekutimit të elementeve teknike e të sigurojë një pjesëmarrje të vetëdijshme në procesin e stërvitjes sportive.

## 2 QËLLIMI I PROGRAMIT TE FUTBOLLIT

Programi synon formimin e nxënësve/sportistëve në sportin e bukur të futbollit. Njohuritë teorike - praktike të shërbejnë për realizimin me sukses të binomit teori–praktikë, me qëllim që të kemi arritje sportive të një niveli të lartë. Me një shpërndarje të njohurive në fushat, njohjen e rregullores, mësimin e detajuar të teknikës në futboll, projekteve të ndryshme gjatë procesit mësimor, synohet rritja e kapaciteteve të nxënësve sportistë të specialitetit të futbollit. Parimi nga më e thjeshta tek më e vështira, vendosja e themeleve më parë, nënkupton se të rinjtë duhet të ecin më parë se sa të vrapojnë. Më parë duhet të mësojnë të gjuajnë e më pas të shënojnë me saktësi.

## 3 SYNIMET E PROGRAMIT TË FUTBOLLIT

Në fund të klasës së 7-të nxënësi/ja duhet të jetë i aftë:

- të përvetësojë teknikën e elementeve bazë të lojës së futbollit;
- të përdorë në elementet teknike në përmirësim si pasimi, udhëheqja e topit driblimi, marrja e topit, rivënia anësore, goditja e topit;
- të krijojë shprehitë lëvizore, të domosdoshme për nxënësin;

- të demonstrojë zbatimin e rregullores teknike të futbollit;
- të zbatojë kuptimin e vlerave shëndetësore të veshjes, pastërtisë së trupit e të mjedisit gjatë dhe pas të ushtruarit.

#### 4 KOHA MËSIMORE PËR ÇDO TEMATIKËTË PROGRAMIT

Lënda “Futboll” zhvillohet për 35 javë mësimore me nga 3 orë secila, pra gjithsej 105 orë për klasën e shtatë. Ky program specifikon peshën (orët e sugjeruara) të secilës tematikë. Shuma e orëve sugjeruese për secilën tematikë është e barabartë me sasinë e orëve vjetore, të përcaktuara në planin mësimor të arsimit bazë për klasat e profilizuara sportive. Kjo ka si qëllim që përdoruesit e programit të orientohen për peshën që zë secila tematikë në orët totale vjetore.

**Tabela 1: Orë të sugjeruara për çdo tematikë**

Tematikat	Matje antropometrike	Matje teknike	Teknika dhe metodika	Aftësi koordinative në kushte lojë	Lojë me temë	Edukim sportiv dhe shëndetësor	Kontrolle periodike	Kontroll vjetor
Orët	2 orë	2 orë	42 orë	20 orë	20 orë	8 orë	9 orë	2 orë
	105 orë							

## 5 PËRMBAJTJA E PROGRAMIT TËFUTBOLLIT, KLASA 7-TË

Programi “Futboll” për klasat me profil sportiv, për klasën e shtatë të AMU-së (Arsimi i Mesëm i Ulët) zhvillohet përmes përmbajtjeve të detyrueshme të tematikave që ajo përmban. Ato janë:

1. Matje antropometrike  
Matje teknike
2. Teknika dhe metodika
3. Aftësi koordinative në kushte loje
4. Lojë me temë
5. Edukim sportiv dhe shëndetësor
6. Kontrollë periodike
7. Kontroll vjetor

Këto tematika janë bazë për të siguruar rezultatet e të nxënit në profilin futboll. Për secilën tematikë janë paraqitur njohuritë që duhet të demonstrojë nxënësi lidhur me nëntematikat përkatëse. Tematikat dhe renditja e tyre nuk janë të detyrueshme, por çdo mësues e zhvillon përmbajtjen e lëndës përgjatë vitit shkollor. Kombinimi dhe ndërthurja e tyre në grupe temash apo tema të veçanta mësimore, si dhe renditja e tyre është e drejtë e përdoruesve të programit.

## 6 NJOHURITË DHE REZULTATET E TË NXËNIT, SIPAS TEMATIKAVE, KLASA E SHTATË

<b>Tematika 1: Matje antropometrike</b>	
<b>Përshkrimi i tematikës:</b> Matjet antropometrike, në mënyrë shumë të thjeshtë dhe shkencore, përcaktojnë treguesit e përbërjes trupore (përbërja dhjamore, spektrin e patologjive të infarktut, sëmundjeve të zemrës, mbitensionit) pra evidentojnë një gjendje të shëndetshme normale ose atë problematike dhe orientojnë për përmirësime të mundshme në kohë, në favor të shëndetit.	
<b>Rezultatet e të nxënit të tematikës:</b> <i>Në fund të kësaj tematike:</i> <ul style="list-style-type: none"><li>- kryhen matjet antropometrike për çdo nxënës;</li><li>- realizohet progresi i nxënësve në vazhdimësi;</li><li>- vlerësohen aftësitë lëvizore të teknikës, mënyra se si ata koordinohen me topin gjatë demonstrimit;</li><li>- realizohet lidhja organike e elementeve teknike të mësuara më parë në masën mirë dhe shumë mirë, duke koordinuar lidhjen e disa elementeve bashkë dhe ekzekutim të mirë.</li></ul>	
<b>Njohuritë e lëndës futboll</b>	<b>Rezultatet e pritshme</b>
<ul style="list-style-type: none"><li>○ Matje antropometrike</li><li>○ Matje teknike</li></ul>	<ul style="list-style-type: none"><li>- krijohen databaza për të dhënat e matjeve antropometrike;</li><li>- krahasohen ndryshimet e vazhdueshme të ecurisë së nxënësit.</li></ul>
<b>Tematika 2: Teknika dhe metodika</b>	
<b>Përshkrimi i tematikës:</b> Kjo tematikë ka për qëllim t'u japë mundësi nxënësve të përvetësojnë teknikat e elementeve bazë të futbollit të mësuara një vit më parë (udhëheqja e topit, rivënie anësore, goditje e topit, marrja e topit, pasimi, driblimi), duke njohur rrugën metodike të këtyre elementeve dhe aplikimin e tyre në fushë.	

**Rezultatet e të nxënit të tematikës:**

*Në fund të kësaj tematike:*

- kryhen elementet bazë të një shkalle ekzekutimi më të avancuar teknikisht;
- demonstrohen elementet teknike të pasimit të topit me saktësi;
- realizohen elementet teknike të driblimit me anë të finteve;
- kryhet saktë koordinimi i rivënies anësore, koordinimi i duarve me këmbët.

**Njohuritë e lëndës futboll****Rezultatet e pritshme**

- Qëndrimet dhe lëvizjet në fushë
- Udhëheqja e topit
- Driblimi
- Pasimi
- Marrja e topit
- Goditja e topit
- Rivënia anësore

Nxënësi/ja:

- realizon qëndrimet dhe lëvizjet në fushë sipas standardit teknik të kërkuar;
- realizon udhëheqjen e topit sipas standardeve teknike përkatëse;
- realizon elementin teknik të driblimit sipas kërkesave përkatëse teknike;
- realizon pasimin e topit sipas standardit teknik të kërkuar;
- realizon marrjen e topit sipas standardeve të kërkuara;
- realizon goditjen e topit hapësira këmbë-top sipas standardeve të kërkuara;
- realizon hedhjen e rivënies anësore sipas standardeve teknike të kërkuara

**Tematika 3: Aftësi koordinative në kushte lojë**

**Përshkrimi i tematikës:** Rëndësi të veçantë ka kompletimi i të gjithë lojtarëve me aftësi për përvetësimin sa më të mirë të elementeve teknike duke pasur parasysh gjithmonë kushtet dhe kërkesat që na paraqet loja. Për të arritur këtë qëllim kjo tematikë na jep informacione më të detajuara për zhvillimin e aftësive koordinative të nxënësve.

**Rezultatet e të nxënit të tematikës:**



*Në fund të kësaj tematike:*

- rritet dhe zhvillohet reagimi në situata të ndryshme të lojës me anë të ushtrimeve;
- zhvillohen aftësitë koordinative në fushë nëpërmjet ndërlidhjes se elementeve teknike;
- demonstron përballja në situata të ndryshme të lojës.

#### **Njohuritë e lëndës futboll**

#### **Rezultatet e pritshme**

- Ushtrime koordinimi të lëvizjes pa top.
- Ushtrime koordinimi me top në ½ fushë dhe në të gjithë fushën.
- Ushtrime koordinimi me dhe pa kundërshtar.

Nxënësi/ja:

- zhvillon reagimin në situata të ndryshme të lojës;
- koordinon në fushë elementet teknike;
- reagon pozitivisht ndaj çdo situatë që paraqet loja.

#### **Tematika 4: Lojë me temë**

**Përshkrimi i tematikës:** Padyshim që të luash futboll në skuadër do të thotë të respektosh rregulla të ndryshme: detyrat e brendshme- rregullat e stërvitjes – rregullat e lojës. Në këtë mënyrë nuk duhet të jenë të aftë të bëjnë ekzaktësisht çfarë ata duan , por për të respektuar rregulla të ndryshme që rrisin bashkëzistencën e tyre me të tjerët. Kjo është njëra prej shumë aspekteve edukative të vlefshme të futbollit si sport garues.

#### **Rezultatet e të nxënit të tematikës:**

*Në fund të kësaj tematike:*

- përvetësohet koordinimi i lëvizjeve të elementeve të mësuara;
- demonstron me saktësi elementet e mësuara dhe përdoren ato në kushte loje;
- zhvillohet bashkëveprimi me të tjerët në kushte loje.

Njohuritë e lëndës futboll	Rezultatet e pritshme
<ul style="list-style-type: none"> <li>○ Lojë pa driblim ne ½ fushë dhe në të gjithë fushën.</li> <li>○ Lojë vetëm me një driblim në ½ fushë dhe në të gjithë fushën.</li> <li>● Lojë ku lojtarit i shikohet mënyra e ekzekutimit të pasit.</li> <li>● Lojë 5 vs 5 me rregulla të thjeshtuara.</li> </ul>	<p>Nxënësi/ja:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- përvetëson koordinimin e lëvizjeve të elementeve të mësuara;</li> <li>- demonstroi dhe përdori me saktësi elementet e mësuara në kushte loje;</li> <li>- bashkëvepron me të tjerët në kushtet e lojës;</li> <li>- demonstroi me saktësi pasimin drejt shokut;</li> <li>- nxënësit arrijnë të kryejnë elementet teknike në kushte loje.</li> </ul>
<b>Tematika 5: Edukim sportiv dhe shëndetësor</b>	
<p><b>Përshkrimi i tematikës:</b> Në këtë tematikë do të shqyrtohet rëndësia e të veshurit dhe të ushqyerit në sport dhe rregullat bazë të lojës së futbollit.</p>	
<p><b>Rezultatet e të nxënit të tematikës:</b></p> <p><i>Në fund të kësaj tematike:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- zhvillohen njohuritë bazë të rregullores së gjyqtarisë së futbollit;</li> <li>- demonstroi zbatimin me përpikmëri i mënyrës së ushqyerit;</li> <li>- shpjegohet domosdoshmëria e zbatimit me rigorozitet i higjienës së të veshurit para dhe pas stërvitjes;</li> <li>- shpjegohet historiku i futbollit në Shqipëri dhe Europë;</li> <li>- shpjegohet funksionimi dhe ndërtimi i muskujve bazë.</li> </ul>	
<p><b>Njohuritë e lëndës futboll</b></p>	<p><b>Rezultatet e pritshme</b></p>
<ul style="list-style-type: none"> <li>● Rregullore teknike e lojës së futbollit.</li> </ul>	<p>Nxënësi/ja:</p>

<ul style="list-style-type: none"> <li>• Parimet e të ushqyerit dhe të veshurit.</li> <li>• Historiku në Shqipëri dhe Europë.</li> <li>• Fokusimi në ndërtimin e muskujve në ekstremitete.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- zbaton rregulloren e futbollit(fusha e lojës, pesha e topit, nr i lojtarëve, përmasat e portës);</li> <li>- demonstroi përpikmëri në mënyrën e të ushqyerit shëndetshëm.</li> <li>- shpjegon historikun e futbollit në Shqipëri dhe Europë.</li> <li>- shpjegon ndërtimin dhe funksionimin e muskujve të krahëve dhe këmbëve.</li> </ul>
---	---

### Tematika 6: Kontrole periodike

**Përshkrimi i tematikës:** Kjo tematikë përshkruan kontrollet periodike të bëra për çdo element të mësuar ku përfshihen dhe qëndrimet etiko-sociale në përgjithësi dhe ato të bashkëpunimit me të tjerët, në veçanti dhe shërben për përmirësimin e vazhdueshëm të procesit mësimor dhe ecurisë profesionale të nxënësit.

**Rezultatet e të nxënit të tematikës:**

*Në fund të kësaj tematikë:*

- kontrollohet për përvetësimin e elementeve teknike;
- kontrollohet për njohuritë e marra për rregulloren e gjyqtarisë në futboll;
- kontrollohet për njohuritë e marra rreth mënyrës së shëndetshme të të ushqyerit dhe të veshurit.

**Njohuritë e lëndës futboll**

**Rezultatet e pritshme**

<ul style="list-style-type: none"> <li>○ Kontroll për elementet teknike.</li> <li>○ Kontroll për rregulloren bazë të futbollit.</li> <li>○ Kontroll udhëheqja e topit.</li> <li>○ Kontroll driblimi.</li> <li>○ Kontroll pasimi i topit.</li> <li>○ Kontroll marrja e topit.</li> <li>○ Kontroll goditja e topit.</li> <li>○ Rivënia anësore.</li> <li>● Kontroll për parimet bazë të të ushqyerit dhe të veshurit.</li> </ul>	<p>Nxënësi/ja:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- demonstroi aftësitë teknike të përvetësuara;</li> <li>- zbaton rregulloren bazë të futbollit</li> <li>- realizon udhëheqjen e topit sipas standardeve teknike përkatëse;</li> <li>- realizon elementin teknik të driblimit sipas kërkesave përkatëse teknike;</li> <li>- realizon pasimin e topit sipas standardit teknik të kërkuar;</li> <li>- realizon marrjen e topit sipas standardeve të kërkuara;</li> <li>- realizon goditjen e topit hapësira këmbë-top sipas standardeve të kërkuara;</li> <li>- realizon hedhjen e rivënies anësore sipas standardeve të kërkuara;</li> <li>- identifikon rëndësinë e të veshurit dhe të ushqyerit shëndetshëm.</li> </ul>
--	---

### Tematika 7 : Kontrolli vjetor

**Përshkrimi i tematikës:** Në këtë tematikë do të përcaktohet se në çfarë niveli e ka përvetësuar çdo nxënës programin mësimor të klasës së 7-të. Nxënësit do t'i nënshtrohen një testi për çdo element teknik të zhvilluar në këtë program ku do të vlerësohet vetëm për realizimin teknik të këtyre elementeve.

**Rezultatet e të nxënësve të tematikës:**

*Në fund të kësaj tematike:*

- testohet për ekzekutimin teknik në standardet e kërkuara të elementit teknik të futbollistit;
- testohet për ekzekutimin teknik në standardet e kërkuara të elementit të pasimit;
- testohet për ekzekutimin teknik në standardet e kërkuara të elementit të driblimit;
- testohet për ekzekutimin teknik në standardet e kërkuara të elementit të udhëheqjes së topit, marrjes së topit, rivënia anësore.

<b>Njohuritë e lëndës futboll</b>	<b>Rezultatet e pritshme</b>
<ul style="list-style-type: none"><li>• TESTIM përfundimtar për elementet teknike të mësuar.</li></ul>	Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"><li>- respekton procesin e zhvillimit të testimit;</li><li>- demonstroi përkushtim maksimal në paraqitjen sa më të mirë në testim;</li><li>- tregon etikë sportive në kërkesat që paraqet testimi.</li></ul>

## **7 UDHËZIME METODOLOGJIKE PËR ZBATIMIN E PROGRAMIT**

Organizimi i mirë i procesit të mësimin të “Futbollit”, do të thotë që fëmijët të vendosen në situata konkrete praktike, ku ata përjetojnë dhe provojnë elementet teknike dhe metodike të futbollit në lojë. Organizimi i mirë i procesit të mësimin të sportit të futbollit, do të thotë që fëmijët të vendosen në situata konkrete praktike, ku ata përjetojnë dhe përvetësojnë elementet teknike të futbollit. Futbolli nuk është thjesht argëtues për ta, por një punë serioze, që do dominojë në vazhdimin e jetës së tyre, duke u thithur pjesën më të madhe të kohës e të energjisë, duke edukuar aftësi dhe formuar sjellje shoqërore, si kontribut themelor në kërkesën për rritjen e shpejtë dhe të shëndetshme. Në orët e mësimin të edukimit fizik, sportiv e shëndetësor do t’i vihet theks i madh lojës së futbollit dhe elementeve teknike përbërëse dhe të kujdesen për higjienën e trupit gjatë dhe pas aktivitetit fizik.

Parimi nga më e thjeshta tek më e vështira, vendosja e themeleve më parë, nënkupton se fëmijët duhet të ecin më parë se sa të vrapojnë. Më parë duhet të mësojnë anën teknike të tyre. Fëmijët padyshim duhet të kryejnë me sukses veprime ose lëvizje të vetme para se të ekzekutojnë kombinime të tyre. Fëmijët ,që kanë zotëruar mirë bazat, janë shumë më të sigurt me aftësitë e tyre lëvizore dhe për pasojë me të njëjtën siguri do të vazhdojnë gjatë gjithë jetës.

## 8 UDHËZIME PËR VLERËSIMIN E NXËNËSVE

Vlerësimi i nxënësit përshkon gjithë procesin mësimor dhe shërben për përmirësimin e këtij procesi. Vlerësimi i nxënësit nuk ka për qëllim të vetëm vendosjen e notës dhe as nuk përfundon me vendosjen e saj. Ai mbështetet tërësisht në përmbajtjen e programit lëndor dhe mësuesi nuk ka të drejtë të vlerësojë nxënësit për ato kompetenca që nuk përshkruhen në program.

Mësuesi zhvillon vetë dhe ndihmon nxënësit të zhvillojnë një larmi mënyrash vlerësimi, si për shembull:

NR.	ELEMENTET E VLERËSIMIT	REZULTATET E ARRITJEVE	NIVELET E ARRITJEVE
1	Udhëheqja e topit	Nxënësi/ja realizon: - udhëheqjen e topit në vijë të drejtë.(20 m).	N 2 (nota 5-6)
		Nxënësi/ja realizon: - udhëheqjen e topit në vijë të drejtë duke e mbajtur topin në kontroll sa më afër këmbës (20 m).	N 3 (nota 7-8)
		Nxënësi/ja realizon: - udhëheqjen e topit në vije të drejtë duke e mbajtur topin afër këmbës dhe me shikimin lart(20m).	N 4 (nota 9-10 )
2	Pasimi	Nxënësi/ja realizon:	N 2 (nota 5-6)

		- 7 pasime të sakta drejt një objektivi të caktuar në largësinë 5 m;	
		Nxënësi/ja realizon: - 7 pasime të sakta drejt një objektivi të caktuar në një largësi 7m duke vendosur këmbën mbështetëse paralel me topin;	N 3 (nota 7-8)
		Nxënësi/ja realizon: - 10 pasime të sakta drejt një objektivi të caktuar në një largësi 7m duke vendosur këmbën mbështetëse paralel me topin.	N 4 (nota 9-10 )
3	Marrje topit	Nxënësi/ja realizon: - marrjen e topit nga një distancë e afërt 7 m. Sulmon topin pa kundërshtarë.	N 2 (nota 5-6)
		Nxënësi/ja realizon: - marrjen e topit nga një distancë e afërt 10m. Sulmon topin për kontrollin e tij para se ta kapë kundërshtari.	N 3 (nota 7-8)
		Nxënësi/ja realizon:	N 4 (nota 9-10 )

		- me shpejtësi marrjen e topit me kundërshtar në krah 10 m.	
4	Goditja e topit	Nxënësi/ja realizon: - goditjen e topit në një distancë 20m duke i dhënë trajektore (3x).	N 2 (nota 5-6)
		Nxënësi/ja realizon: - goditjen e topit në një distancë 20 m duke i dhënë trajektore topit brenda nje rrezeje të caktuar (3x).	N 3 (nota 7-8)
		Nxënësi/ja realizon: - goditjen e topit në distancë 20m duke i dhënë topit trajektore duke e dërguar atë brenda një rrethi të vendosur në toke (3x).	N 4 (nota 9-10 )
5	Rivënia anësore	Nxënësi/ja realizon: - hedhjen e topit nga rivënia anësore nga vendi pa bërë faull.	N 2 (nota 5-6)



		Nxënësi/ja realizon: - hedhjen e topin në rivënie anësore me një hap para pa bërë faull.	N 3 (nota 7-8)
		Nxënësi/ja realizon: - hedhjen e topit në rivënie anësore me vrull pa bërë faull.	N 4 (nota 9-10 )
6	Driblimi	Nxënësi/ja realizon: - një driblim ndaj kundërshtarit (hinkë) duke e sulmuar atë për ta dribluar (një kundërshtar).	N 2 (nota 5-6)
		Nxënësi/ja realizon: - dy driblime ndaj kundërshtarit.(hinkat të vendosura diagonal 2 m larg njëri-tjetrit duke i dribluar ato).	N 3 (nota 7-8)
		Nxënësi/ja realizon: - 3 driblime ndaj kundërshtarit ( 3 hinkat të vendosura në formë trekëndëshi 3 m duke i shmangur ato njëri pas tjetrit).	N 4 (nota 9-10)

## 9 MATERIALE BURIMORE

Për zbatimin me sukses të programit “Edukim fizik, sporte dhe shëndet”, profili futboll, është e rëndësishme të përdoren burime të ndryshme mësimore që të motivojnë nxënësin dhe të stimulojnë progresin e tij/saj në mënyrë që të përvetësojë shprehi dhe shkathtësi të nevojshme për përvetësimin sa më të mirë të, aktivitete të ndryshme sportive, projekte, studime të ndryshme, analiza dhe raporte të ndryshme, si dhe librat e tjerë të fushave mësimore teknikave të lojës së futbollit. Baza materiale e sportive janë burime të vlefshme dhe të rëndësishme të të nxënit. Por qasja e nxënësve në informacion nuk duhet kufizuar vetëm në to, por të mundësohen burime tjera të cilat i shërbejnë për të planifikuar dhe realizuar sa më me cilësi procesin mësimor. Për realizimin e mësimin duhet të përdoret një spektër i gjerë i burimeve mësimore, përfshirë bazën materiale-sportive që mundësojnë qasje.